



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 314 prot.

Tiranë, më 21.02.2019

**VENDIM**

**Nr.12, datë 21.02.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 12, DATË 13.03.2018, NË**  
**INSTITUCIONIN E BASHKISË DROPULL**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Hetimit Administrativ Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 12, datë 13.03.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Dropull dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

**KONSTATOVA SE:**

Bazuar në Urdhrin nr. 75 (749 prot.), datë 03/10/2018, “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 12, datë 13.03.2018, të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Dropull.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 2, datë 13.01.2017, nëpërmjet Vendimit nr. 216, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Gjirokastrë dhe në Bashkinë Dropull”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Dropull.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Dropull raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 12, datë 13.03.2018, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në raport dhe në detyrat e lëna për Bashkinë Dropull në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar në subjekt veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

- Në vendimin paralajmërues të Komisionerit në pikën 2 të tij, është lënë detyrë që të rregullohet struktura e institucionit duke zbatuar skemën e funksionimit të shërbimit civil në përputhje me nenin 19 të ligjit për nëpunësin civil.

Për pozicionet e punës, të cilat nisur nga emërtesa dhe nga detyra që ato kryejnë konsiderohen si pozicione pune pjesë e shërbimit civil, por që nga ana e institucionit nuk konsiderohen si të tillë, njësia përgjegjëse është orientuar për radhën e punës në vendimin paralajmërues.

Komisioneri i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse që në strukturën pasardhëse të institucionit, të propozojë ndryshimin e emërtesës për pozicionin e punës të emërtuar “Kryeinspektor”, pranë Drejtorisë së Auditit, duke e emërtuar atë “Përgjegjës Sektor”.

Nga këqyrja e akteve të administruara nga grupi i punës gjatë verifikimit në subjekt, vërej se:

Bashkia Dropull, me miratimin e strukturës së re organizative me urdhrin nr. 60, datë 04.05.2018, të Kryetarit të Bashkisë, ka zbatuar skemën e funksionimit të shërbimit civil në përputhje me parashikimet e nenit 19 të ligjit për shërbimin civil.

Njësia përgjegjëse, në strukturën e re të miratuar, ka analizuar pozicionet e punës pranë njësive administrative, pranë Agjencisë së Shërbimeve Pyjore, Mjedisore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe pranë aparatit të Bashkisë. Njëkohësisht, ka rivlerësuar raportin e tyre me shërbimin civil, duke rregulluar marrëdhënien e tyre të punës dhe duke dalë me një vendim të arsyetuar lidhur me statusin që do të aplikohet në këto raste.

Për sa i përket pozicionit të “*Kryeinspektorit*”, pranë Drejtorisë së Auditit, njësia përgjegjëse ka propozuar për këtë rast emërtesën “*Përgjegjës Sektori*”, e cila gjen zbatim në strukturën e re.

- Në pikën 3 të vendimit paralajmërues është lënë detyrë nxjerrja e akteve të deklarimit për nëpunësit: \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.

Në zbatim të pikës 12, Kreu VI, të VKM 243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, njësia përgjegjëse ka vazhduar me nxjerrjen e akteve të deklarimit për punonjësit e mësipërm, përkatësisht:

1. Për punonjësin \*\*\*\*\*, me aktin nr. 514, dt. 20.03.2018, rezulton se është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Auditi*”.
2. Për punonjësen \*\*\*\*\*, me aktin nr. 518, dt. 20.03.2018, rezulton se është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Arshivist-Pritjes së Qytetarit*”.
3. Për punonjësin \*\*\*\*\*, me aktin nr. 516, dt. 20.03.2018, rezulton se është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist IT*”.
4. Për punonjësin \*\*\*\*\*, rezulton se me aktin nr. 517, dt. 20.03.2018, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Arkitekt*”.
5. Për punonjësen \*\*\*\*\*, rezulton se me aktin nr. 515, dt. 20.03.2018, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Finance*”.
6. Për punonjësin \*\*\*\*\*, rezulton se me aktin nr. 1739/1, dt. 15.12.2016, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Auditi*”

- Në pikën 4 të vendimit paralajmërues i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të përfundojë procesin e deklarimit të punonjësve \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, pas përfundimit me sukses të periudhës së provës.

Konkretisht për punonjësit e mësipërm, pas përfundimit të periudhës së provës, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e deklarimit si më poshtë:

1. Me aktin nr. 1367/1, datë 03.08.2018, punonjësja \*\*\*\*\*, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Auditimi*”.
2. Me aktin nr. 929, datë 22.05.2018, punonjësi \*\*\*\*\*, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Finance*”.
3. Me aktin nr. 758, datë 25.04.2018, punonjësi \*\*\*\*\*, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Inxhinier*”.
4. Me aktin nr. 927, datë 22.05.2018, punonjësi \*\*\*\*\*, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Tatim Taksash*”.
5. Me aktin nr. 927, datë 22.05.2018, punonjësja \*\*\*\*\*, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist Arshivist Protokollist*”.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 12, datë 13.03.2018, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Dropull dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Dropull, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.12, datë 13.03.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Dropull.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**